



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2021

VENDIM
Nr. 532, datë 10.11.2021

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Vladimir Skënderi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Shfuqizim vendimi”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KRUIJË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Suela Lika, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen civile me Paditës: {...}; E paditur: {...}; Objekti: “Detyrim njohje pronar. Marrje mase për sigurim padie”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Murat Lleshi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal”.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË GJIROKASTËR

1. Gjyqtarja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, Ema Shaholli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, çështjen civile me Paditës: {...}; E paditur: {...}; Objekti: “Detyrimin e palës së paditur Bashkia Gjirokastrë t’i paguajë në të holla palës paditëse vlerën e kursyer që i korrespondon vlerës së furnizuar palës paditur si artikuj ushqimorë për kopshtet dhe çerdhet, gjatë periudhave kohore 01.01.2019-31.03.2019, 01.10.2019-31.12.2019 dhe 06.01.2020-10.03.2020, një total prej 3.387.786 lekë, në dëm të palës paditëse, si begatim pa shkak”.

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Iliba Bezati dhe Skënder Damini, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Rishikim vendimi civil”.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Margarita Buhali dhe Laurent Fuçia, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen çështjen gjyqësore me Ankues: {...}; Objekti: “Kundërshtim vendimi mosfillimi”.

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Valdete Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Pjesëmarrës: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec; Objekti: “Kërkohet plotësimi i vendimi nr.(197)-30, datë 17.02.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, për tu shprehur për të gjitha kërkesat për disponimin e provave”. Objekti i shqyrtimit: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Genti Shala, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Rishikimin e vendimit penal nr. (542)-83, datë 29.07.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec”.

3. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, Genti Shala dhe Valdete Hoxha, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Ndhimë për kalim të paligjshëm të kufijve”; “Mosbindje ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik”.

GJYKATA E APELIT SHKODËR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Florjan Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me Paditës: {...}; E paditur: {...}; Objekti: “Njohje pronar”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me Paditës: {...}; I paditur {...}; Objekti: “Njohje pronar”.

GJYKATA E APELIT VLORË

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Enton Dhimitri dhe Sokol Pina, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen civile me Paditës: {...}, etj.; E paditur: {...} .; Objekti: “Shpërblim dëmi”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR